SHTOJCA NR. 1

STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"BP Tech" Sh.p.k.

KAPITULLI I
EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

**Neni 1 – Emërtimi**

1.1 Shoqëria emërtohet BP Tech Sh.p.k. (në vijim "**Shoqëria**").

**Neni 2 – Forma**

2.1 Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe rregullohet prej këtij Statuti dhe Aktit të saj të Themelimit.

2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 3 – Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga "Urani Pano" 1/A.

3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në vende të tjera në Shqipëri si edhe jashtë saj.

3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, shoqëri të kontrolluara, degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi si dhe çfarëdolloj entiteti tjetër të çdo lloji.

**Neni 4 – Objekti**

4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në vijim:

Krijimin e një software house, e cila realizon, tregton dhe shpërndan produkte software dhe hardware në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.

4.2 Shoqëria mund (i) të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në *consortium*-e edhe të përkohshme, *joint venture* ose (ii) të zotërojë, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të; jo si aktivitet parësor, Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë peng, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër në përputhje me ligjin.

### Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë deri në 31 dhjetor të vitit 2050 dhe mund të zgjatet edhe më tej me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## KAPITULLI II
## KAPITALI, KONTRIBUTET,
## NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

### Neni 6 – Kapitali i Shoqërisë, Kontributet dhe Kuotat

6.1. Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 123.000,00 Lekë (njëqind e njëzet e tre mijë Lekë) [ekuivalenti në Euro 1.003 (një mijë e tre Euro) sipas kursit të sotëm të këmbimit Lekë/Euro 122.6] dhe është aktualisht i ndarë në 2 (dy) kuota si më poshtë. Kapitali mund të shlyhet me kontribute në para ose kontribute në natyrë.

6.2 Kapitali themeltar është i nënshkruar si me poshtë:

i. **BPOINT INTERNATIONAL HOLDING S.R.L.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës italiane, me seli ligjore në Terracina (LT), Via Traiano 45 CAP 04019 – Itali, me kod fiskal dhe nr. regjistrimi në Regjistrin e Biznesit 03137970590, numër REA LT – 303939, nënshkruan një kuotë në para për vlerën 110.700,00 Lekë (njëqind e dhjetë mijë e shtatëqind Lekë), e cila përfaqëson 90% (nëntëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë;

ii. **Z. Dorart Sopoti**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 29 qershor 1970, me pasaportë shqiptare nr. BA3403632 dhe nr. personal H00629035B, nënshkruan një kuotë në para për vlerën 12.300,00 Lekë (dymbëdhjetë mijë e treqind Lekë), e cila përfaqëson 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

### Neni 7 – Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë

7.1 Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, kurdo dhe për më shumë se një herë, përmes kontributit në para apo në natyrë apo në kredi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

7.2 Në rast zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në proporcion me vlerën nominale te kuotës që ata zotërojnë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme që vendos për zmadhimin e kapitalit duhet të vendosë edhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet shlyerja e tij. Në rast se zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë nuk nënshkruhet dhe shlyhet nga ana e të gjithë ortakëve brenda afatit të përcaktuar në vendim, atëherë pjesa e kapitalit të panënshkruar mund të nënshkruhet dhe shlyhet në proporcion me vlerën nominale te kuotës te zotëruar nga ortakët e tjerë. Vetëm nëse këta ortakë nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesa e zmadhimit të kapitalit akoma e panënshkruar dhe e pashlyer mund t'i ofrohet të tretëve. Vendimi përkatës i Asamblesë së Ortakëve rregullon termat dhe kushtet e tjera të zmadhimit të kapitalit.

7.3 Nëse kapitali i Shoqërisë nuk nënshkruhet dhe shlyhet tërësisht, kapitali zmadhohet me një vlerë të barabartë me nënshkrimet dhe shlyerjet e mbledhura, vetëm nëse vendimi përkatës i Asamblesë së Përgjithshme e ka autorizuar shprehimisht.

7.4 Zmadhimi i kapitalit nuk mund të kryhet deri në momentin kur kuotat e emetuara më parë të jenë shlyer tërësisht.

**Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë**

8.1. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.

8.2. Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak në proporcion me vlerën nominale te kuotës që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

**Neni 9 – Transferimi i kuotave**

9.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe në favor të të tretëve, përveç sa parashikohet shprehimisht në këtë nen.

9.2 Në rast transferimi, tërësor ose të pjesshëm të kuotave në favor të të tretëve, ortakët e tjerë të Shoqërisë kanë të drejtë parablerje.

9.3 Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë pronësinë e kuotës së tij ose një pjesë të saj në favor të të tretëve duhet të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë, mbi synimin për tranferimin e pronësisë, duke përcaktuar çmimin, kushtet dhe afatet e pagesës si dhe emrin e bleresit.

9.4 Ortakët e tjerë do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga marrja e njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotën, synimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes mbi kuotën e ofruar kundrejt të njëjtit çmim sipas njoftimit. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen në afatin e caktuar më sipër, prezumohet se kanë hequr dorë nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes.

9.5 E drejta e parablerjes i takon ortakut edhe në rastin e dhurimit të kuotave të tretëve.

9.6 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet vetëm për një pjesë të kuotave të ofruara për transferim.

9.7 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet në rast të transferimit të kuotave midis ortakëve.

9.8 Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, atëherë kuota e ofruar për shitje do të blihen nga ortakët në proporcion me vlerën nominale te kuotës se tyre në Shoqëri.

9.9 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'i transferohen lirishit të tretëve sipas njoftimit te parashikuar në nenin 9.3 më sipër kundrejt çmimit, afateve dhe kushteve të pagesës së parashikuara aty.

9.10 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet në rastin kur subjekti, të cilit do t'i transferohen kuotat është: (i) një shoqëri drejtpërsëdrejti ose tërthorazi e kontrolluar nga ortaku që ka si qëllim të transferojë kuotat në fjalë; (ii) një shoqëri ose individ, i cili drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kontrollon ortakun që ka si qëllim të trasferoje kuotat në fjalë; (iii) subjekti të cilit do t'i transferohet kuota dhe ortaku që ka si qëllim të kryejë këtë transferim janë të dy nën kontrollin e përbashkët të një shoqërie të tretë. Në këtë rast

ortaku që ka si qëllim të transferoje kuoten duhet të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë, duke bashkangjitur dokumentacionin që provon lidhjen e mësipërme.
Për më shumë qartësi, në kuptimin e kësaj dispozite, "kontroll" do të thotë të kesh në pronësi direkt ose indirekt shumicën absolute të totalit të votave (pra 50%+1).

9.11 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet në rastin e transferimit të kuotave për shkak të bashkimit, ndarjes dhe transformimit të ortakëve.

9.12 Trasferimi i kuotave në favor të të tretëve është i pavlefshëm dhe nuk ka efekt nëse nuk kryhet sipas parashikimeve të këtij neni.

9.13 Ortakët nuk mund të vënë peng ose barrë tjeter mbi kuotat e Shoqërisë që kanë në pronësi pa marrë miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

## KAPITULLI III
## ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATORËT

### Neni 10 – Asambleja e Përgjithshme, të drejtat e pjesëmarrjes dhe votës, thirrja

10.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

10.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shpreh mendimin e tij dhe ka të drejta vote në proporcion me vlerën nominale të kuotës në pronësinë e tij. Ortaku nuk mund të votojë në një mënyrë me një pjesë të kuotës dhe në një mënyrë tjetër me pjesën e mbetur të saj.

10.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, edhe jo ortak, i pajisur me prokurë apo me një autorizim të thjeshtë, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura ose autorizimi do të mund të lëshohet vetëm për një Asamble të Përgjithshme dhe është i vlefshëm për thirrjen e parë dhe vijuese të saj.

10.4 Ortaku nuk mund të japë prokurë ose autorizim për të votuar për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për pjesën e mbetur.

10.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj.

10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit, në të gjitha rastet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë, të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkese të shkruar drejtuar Administratorit. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda muajit të qershorit, me qëllim që të diskutojë dhe miratojë bilancin vjetor të vitit të mëparshëm fiskal.

10.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike me evidencë marrje dërguar ortakëve në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.

10.8 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mblidhet.

10.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar me autorizim dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.

10.10 Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet me telekonferencë dhe videokonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës.

10.11 Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari.

10.12 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me telekonferencë dhe videokonferencë.

10.13 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga një Kryetar i zgjedhur nga vetë Asambleja. Nëse prania e një noteri nuk është e nevojshme, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë ortak.

10.14 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen prej Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme dhe Sekretarit.

10.15 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë autorizimet dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmërisht. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.

10.16 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë së Përgjithshme duhet të përgatiten menjëherë pas mbajtes së saj dhe duhet të nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga ligji dhe regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.

10.17 Pavarësisht nga sa më sipër, një vendim i Asamblesë së Përgjithshme mund të merret vlefshmërisht edhe me anë të një vendimi qarkullues me shkrim, me kusht që ky vendim qarkullues të nënshkruhet nga të gjithë ortakët. Propozimi i vendimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sqarues bashkëngjitur duhet t'i dërgohet me radhë të gjithë ortakëve, me çdo mjet të përshtatshëm që provon marrjen e tij nga këta të fundit. Nga propozimi duhet të rezultojë në mënyrë të qartë çështja në rend të ditës dhe gjithë sa është e nevojshme për të siguruar informacionin e duhur mbi çështjen në fjalë, si dhe teksti përfundimtar i vendimit që duhet nënshkruar. Nënshkrimi i vendimit nga secili prej ortakëve shpreh pozicionin përkatës të secilit prej tyre. Kuorumi i vendimarrjes është ai që është i parashikuar në nenin 11 të Statutit. Do të konsiderohet datë e vendimarrjes data në të cilin është materializuar nënshkrimi i ortakut të fundit. Këto vendime dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues që shpreh vullnetin e tyre duhet të regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.

## Neni 11 – Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblesë

11.1 Asambleja e Përgjithshme është kompetente për të vendosur mbi të gjitha çështjet që ligjet në fuqi dhe Statuti i rezervojnë asaj.

11.2 Me përjashtim të rastit kur ky Statut parashikon shprehimisht ndryshe, Asambleja e Përgjithshme mblidhet rregullisht dhe mund të marrë vendime të vlefshme me votën pro të 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

11.3 Pa cënuar sa më sipër, në lidhje me çështjet e mëposhtme Asambleja e Përgjithshme mblidhet rregullisht dhe mund të marrë vendime të vlefshme me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë:

i. modifikimi i Statutit;
ii. zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
iii. riorganizimi, likuidimi dhe prishja e Shoqërisë ose revokimi i vendimeve në lidhje me veprimet në fjalë;
iv. bashkimi, përthithja ose ndarja e Shoqërisë;
v. vendimet për shpërndarjen ose mosshpërndarjen e dividendit;
vi. vënien e pengut ose të një barre tjetër mbi kuotat e Shoqërisë.

## Neni 12 – Administratori

12.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator.

12.2 Administratori qëndron në detyrë deri në dhënien e dorëheqjes ose deri në momentin e revokimit prej Asamblesë së Përgjithshme, për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh nga momenti i emërimit, me të drejtë riemërimi. Nëse në përfundim të afatit 5 (pesë) vjeçar, nuk është mbledhur Asambleja e Përgjithshme për të emëruar Administratorin e ri, Administratori do të vazhdojë në detyrë me tagra të plota deri në mbledhjen e radhës të Asamblesë së Përgjithshme që vendos për emërimin e Administratorit të ri.

12.3 Administratorit i takon përfaqësimi i Shoqërisë kundrejt të tretëve, në gjykatë dhe ushtron të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti, të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" ("Ligji Tregtar") dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

12.4 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve, të cilëve mund t'u delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

12.5 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e akteve të caktuara ose kategorive të akteve, brenda kufijve të kompetencave të dhëna nga ky Statut, Ligji Tregtar dhe nga Asambleja e Përgjithshme.

12.6 Detyra e Administratorit është pa pagesë, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe. Administratorit i takon rimbursimi i shpenzimeve të mbajtura si pasojë e ushtrimi të funksioneve të tij.

12.7 Administratori ka për detyrë të informojë ortakët e Shoqërisë në lidhje me veprimtarinë e tij, të paktën çdo tre muaj ose në vijim të kërkesës së ortakëve.

## KAPITULLI IV
## EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

### Neni 13 – Eksperti kontabël i regjistruar

13.1 Nëse kërkohet nga ligji apo një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një apo më shumë ekspertëve kontabël të regjistruar.

13.2 Eksperti kontabël i regjistruar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

### Neni 14 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

14.2 Bilanci dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratorit dhe raporti që, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar, miratohen prej Asamblesë së Përgjithshme me shumicën e votave të kërkuar në paragrafin 11.2 më sipër.

14.3 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

### Neni 15 – Fitimet

15.1 Me kusht që të jetë respektuar neni 77 i Ligjit Tregtar, fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor i Shoqërisë i shpërndahen – me vendim te Asamblesë se Përgjithshme me voten pro të ortakëve të parashikuar në nenin 11.3 më sipër - ortakëve ne proporcion me vlerën nominale te kuotës në kapitalin e Shoqërisë që ata kanë përkatësisht në pronësi, pasi është zbritur shuma që Asambleja e Përgjithshme vendos lirisht të destinoje si rezerve.

15.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë lirisht të mbajë të gjithë fitimet ose një pjesë të tyre si rezerve, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimit – tërësisht apo pjesërisht – në vitet ushtrimore pasardhëse.

## KAPITULLI V
## SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

### Neni 16 – Shpërndarja

16.1 Shoqëria shpërndahet në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e parashikuar për modifikimin e Statutit të Shoqërisë.

### Neni 17 – Likuidimi

17.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në likuidim.

17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron, me shumicën e votave të parashikuar në nenin 11.3 më sipër, një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivit të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

17.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim, me shumicën e votave të parashikuar në nenin 11.3 më sipër, në lidhje me bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit.

17.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve dhe tërheqjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, ne proporcion me vlerën nominale te kuotës që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

## KAPITULLI VI
## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 18 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Statuti mes Shoqërisë dhe ortakëve apo mes ortakëve, do të lihen nën kompetencën ekskluzive të Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

### Neni 19 – Dispozitat ligjore në fuqi

19.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

### Neni 20 – Gjuha

20.1 Ky Statut është hartuar në gjuhën shqipe dhe ka bashkëngjitur përkthimin në gjuhën italiane.

20.2 Në rast konflikti në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin këtij Statuti, versioni në italisht do të jetë i vetmi ligjërisht detyrues.

ORTAKËT

**Për BPOINT INTERNATIONAL HOLDING S.R.L.**

Z. Giuliano Zinni

GIULIANO ZINNI

**Sig. Dorart Sopoti**

DORART SOPOTI

PËRKTHYES

Blerina Mikolla

## ALLEGATO N. 1

## STATUTO
## DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA

## "BP Tech" Sh.p.k.

## TITOLO I
## DENOMINAZIONE, FORMA, SEDE, OGGETTO E DURATA

### Articolo 1 – Denominazione

1.1 La denominazione della società è BP Tech Sh.p.k. (in seguito "**Società**").

### Articolo 2 – Forma

2.1 La Società è costituita in forma di società a responsabilità limitata, ed è regolata dal presente Statuto e dall'Atto Costitutivo della stessa.

2.2 La Società opera secondo la legislazione albanese in vigore.

### Articolo 3 – Sede

3.1 La sede legale della Società è stabilita in Tirana, Rruga "Urani Pano" 1/A.

3.2 La Società potrà costituire filiali, rami, rappresentanze ed agenzie in altre città dell'Albania ed anche all'estero.

3.3 L'Assemblea dei soci potrà decidere l'apertura, il trasferimento e/o la chiusura di società controllate, filiali, agenzie e uffici di rappresentanza come anche ogni altro tipo di persona giuridica, in Albania ed all'estero.

### Articolo 4 – Oggetto sociale

4.1 La Società ha come oggetto sociale lo svolgimento delle attività commerciali come di seguito indicato:

Costituzione di una software house, che realizzi, commercializzi e distribuisca sul territorio albanese e/o all'estero prodotti software ed hardware.

4.2 La Società potrà (i) partecipare finanziariamente o operativamente anche in associazioni temporanee di imprese, joint venture o (ii) possedere, acquistare e vendere partecipazioni in altre entità, società o imprese anche se in fase di start-up, aventi oggetto affine, complementare o comunque connesso al proprio; la Società potrà concedere garanzie reali e/o personali, pegno, fideiussioni, garanzie ipotecarie a favore di terzi senza che ciò diventi attività primaria.

4.3 La Società potrà infine compiere ogni atto o operazione mobiliare e immobiliare, ogni atto o operazione commerciale, industriale e finanziaria utile o complementare al conseguimento delle finalità sociali, come anche ogni altra attività in conformità con la legislazione in vigore.

### Articolo 5 - Durata

5.1 La durata della Società è fino al 31 Dicembre 2050 e potrà essere prorogata con delibera dell'Assemblea dei soci.

## CAPITOLO II
## CAPITALE SOCIALE, CONFERIMENTI, DISTRIBUZIONE E TRASFERIBILITA' DELLE QUOTE

### Articolo 6 - Capitale sociale, Conferimenti e Quote

6.1 Il capitale sociale è di ALL 123.000,00 (centoventitremila/00 Lekë Albanesi) [equivalente in Euro a 1.003 (milletre Euro) in base all'odierno tasso di cambio Lekë/Euro 122.6], ed attualmente è suddiviso in 2 (due) quote, come di seguito indicato. Il capitale sociale può essere versato in contanti ovvero in natura.

6.2 Il conferimento del capitale sociale è avvenuto nel seguente modo:

i. **BPOINT INTERNATIONAL HOLDING S.R.L.**, una società a responsabilità limitata di diritto italiano, con sede legale in Terracina (LT), Via Traiano 45 CAP 04019 – Italia, codice fiscale e n. di iscrizione al Registro Imprese 03137970590, numero REA LT – 303939, sottoscrive una quota in denaro ammontante ad ALL 110.700,00 (centodiecimilasettecento/00 Lekë Albanesi), che corrisponde al 90% (novanta per cento) del capitale della Società;

ii. **Sig. Dorart Sopoti**, cittadino albanese, nato a Tirana, il 29 giugno 1970, con passaporto albanese n. BA3403632 e n. personale H00629035B, sottoscrive una quota in denaro ammontante ad ALL 12.300,00 (dodicimilatrecento/00 Lekë Albanesi), che corrisponde al 10% (dieci per cento) del capitale della Società.

### Articolo 7 - Aumenti del capitale sociale

7.1 Il capitale sociale potrà essere aumentato, tramite conferimento in denaro o in natura o di crediti, in qualsiasi momento, una o più volte, con la deliberazione dell'Assemblea dei soci.

7.2 In caso di deliberazione di aumento del capitale sociale, tutti i soci hanno diritto di sottoscrivere l'aumento in proporzione al valore nominale della quota di capitale posseduta. La delibera dell'Assemblea dei soci che approva l'aumento del capitale dovrà determinare il termine entro cui verrà fatto il versamento del capitale da parte dei soci. Nel caso in cui i soci non esercitino questo diritto entro il termine di cui sopra, le loro quote potranno essere sottoscritte e pagate dagli altri soci che abbiano esercitato il loro diritto proporzionalmente al valore nominale della rispettiva quota di capitale posseduta. Se neanche gli altri soci esercitano questo diritto, la parte di capitale non sottoscritta e non pagata potrà essere offerta ad un terzo. Le altre condizioni e termini per l'aumento di capitale sono previste nella relativa delibera dell'Assemblea dei soci.

7.3 Se il capitale sociale non è interamente sottoscritto e pagato, l'aumento di capitale può avvenire limitatamente alla somma pari al capitale sociale che risulta sottoscritto e pagato, previa delibera dell'assemblea che autorizza espressamente questo aumento.

7.4 L'aumento di capitale non può essere eseguito fino a che le quote precedentemente emesse non siano interamente liberate.

### Articolo 8 - Riduzione del capitale sociale

8.1 La Società può ridurre il capitale sociale previa deliberazione dell'Assemblea dei soci, ai sensi di legge. In ogni caso il capitale sociale non può essere ridotto al di sotto del minimo previsto dalla legge.

8.2 La riduzione del capitale è sopportata da ciascun socio proporzionalmente al valore nominale della quota di capitale posseduta.

### Articolo 9 - Trasferibilità delle quote

9.1 Le quote sono liberamente trasferibili tra i soci e verso i terzi, salvo quanto previsto espressamente in questo articolo.

9.2 In caso di trasferimento, totale o parziale, delle quote da parte dei soci ai terzi, gli altri soci della Società hanno il diritto di prelazione per l'acquisto delle medesime.

9.3 In tal caso, il socio che intende trasferire la propria quota ovvero una parte di essa a terzi dovrà comunicare per iscritto agli altri soci la volontà di vendere, con l'indicazione del prezzo, termini e condizioni del pagamento, ed il nome dell'acquirente.

9.4 Gli altri soci avranno 15 (quindici) giorni – a partire dal ricevimento dell'avviso - per comunicare al socio venditore la propria eventuale volontà di esercitare o meno il diritto di prelazione avente ad oggetto la quota offerta in vendita allo stesso prezzo di cui alla comunicazione. Qualora gli altri soci non esercitino il diritto di prelazione entro il termine di cui sopra, il medesimo si intende rinunciato.

9.5 Anche nel caso di donazione delle quote da parte dei soci a terzi, gli altri soci della Società hanno il diritto di prelazione per l'acquisto delle medesime.

9.6 Il diritto di prelazione non può essere esercitato per una parte delle quote oggetto di trasferimento.

9.7 Il diritto di prelazione non può essere esercitato nel caso di trasferimento delle quote tra soci.

9.8 Nel caso in cui l'offerta sia accettata da più soci, la quota del socio alienante sarà suddivisa tra gli accettanti in misura proporzionale al valore nominale della quota di capitale da ciascuno di essi posseduta.

9.9 In caso di mancato esercizio del diritto di prelazione, le quote potranno essere trasferite liberamente a terzi, come da comunicazione di cui all'art. 9.3 di cui sopra e sulla base del prezzo, termini e condizioni di pagamento ivi stabiliti.

9.10 Il diritto di prelazione non può essere esercitato nel caso in cui il soggetto al quale verranno trasferite le quote è: i) una società controllata direttamente o indirettamente dal socio che intende trasferire la propria quota; ii) una società o individuo che controlla direttamente o indirettamente il socio che intende trasferire la quota in oggetto; iii) il soggetto al quale verrà trasferito la quota ed il socio che intende

trasferire la quota, sono soggetti al controllo da parte di una terza società. In questo caso, il socio che intende trasferire la propria quota deve dare comunicazione scritta agli altri soci, inviando in allegato la documentazione che dimostra la relazione tra le predette società.
A titolo di chiarezza, per le finalità di questo articolo, il termine "controllo" significa avere, direttamente o indirettamente, l'assoluta maggioranza dei voti (p.e. 50%+1).

9.11 Il diritto di prelazione non può essere esercitato nel caso di trasferimento delle quote per fusione, scissione e trasformazione dei soci.

9.12 Il trasferimento delle quote da parte dei soci a terzi è nullo e non produce nessun effetto, se fatto in violazione delle disposizioni di cui al presente articolo.

9.13 I soci non possono costituire pegno o altra garanzia sulle quote sociali, salvo l'autorizzazione preliminare con delibera dell'Assemblea dei soci.

## CAPITOLO III
## ASSEMBLEA DEI SOCI ED AMMINISTRATORI

### Articolo 10 - Assemblea dei soci, diritti di partecipazione e di voto, convocazione

10.1 L'Assemblea dei soci è l'organo decisionale della Società.

10.2 Ogni socio ha il diritto di partecipare all'Assemblea e di esprimere tanti voti in proporzione al valore nominale della quota di capitale posseduta. Il socio non può votare in un modo per una parte della sua quota ed in un altro modo per la restante parte della quota.

10.3 Ogni socio ha il diritto di farsi rappresentare da altra persona, anche non socio, munita di procura o semplice delega scritta, attraverso la quale potrà esprimere il proprio voto. In ogni caso, la procura o la delega può essere data per una Assemblea ed è valida per la riunione di detta Assemblea in prima e successiva convocazione.

10.4 Il socio non può conferire alcuna procura o delega di voto per una parte della sua quota, se vota di persona per la restante parte.

10.5 L'Assemblea può essere convocata anche fuori dalla sede sociale, in Albania oppure all'estero.

10.6 L'Assemblea può essere convocata dall'Amministratore, in tutti i casi necessari a salvaguardia dell'interesse della Società, oppure quanto è richiesto dalla legge oltre che per richiesta scritta indirizzata all'Amministratore, da parte di uno o più soci che rappresentino almeno il 5% (cinque per cento) del capitale sociale. L'Assemblea deve comunque essere convocata almeno una volta l'anno, entro il mese di giugno, per l'approvazione del bilancio relativo all'ultimo periodo d'esercizio.

10.7 L'Assemblea deve essere convocata a mezzo lettera scritta raccomandata con ricevuta di ritorno oppure posta elettronica con conferma di consegna fatta pervenire ai soci al loro indirizzo di sede legale o di abitazione oppure di posta elettronica, almeno 7 (sette) giorni prima del giorno fissato per l'Assemblea.

10.8 La convocazione dell'Assemblea deve contenere le informazioni in merito all'ordine del giorno, data, luogo e tempo della riunione dell'Assemblea come anche la data,

luogo e tempo della seconda convocazione, in caso di mancata riunione dell'Assemblea nella prima convocazione.

10.9 L'Assemblea si riterrà regolarmente convocata e costituita anche senza il rispetto delle formalità di convocazione, se é presente o rappresentato l'intero capitale sociale ed i soci dichiarano di essere d'accordo con lo svolgimento della riunione dell'Assemblea senza il rispetto delle formalità di convocazione.

10.10 È ammessa la possibilità che le riunioni dell'Assemblea si tengano per teleconferenza e videoconferenza, a condizione che tutti i partecipanti possano essere identificati e sia loro consentito di seguire la discussione ed intervenire in tempo reale alla trattazione degli argomenti affrontati e votare sugli argomenti all'ordine del giorno.

10.11 Verificandosi questi requisiti, l'Assemblea si considera tenuta nel luogo in cui si trova il Presidente e dove pure deve trovarsi il Segretario della riunione.

10.12 La convocazione dell'Assemblea deve contenere le informazioni in merito al luogo della riunione dell'Assemblea per teleconferenza e videoconferenza che può essere stabilito anche fuori dalla sede sociale.

10.13 Ogni Assemblea è presieduta da un Presidente designato dalla stessa Assemblea. Se la presenza del notaio pubblico non è dovuta l'Assemblea nomina un Segretario, anche non socio.

10.14 Le deliberazioni dell'Assemblea devono essere sottoscritte dal Presidente dell'Assemblea e dal Segretario.

10.15 Il Presidente ha il diritto di verificare le autorizzazioni e la loro validità, il diritto dei soci e dei loro rappresentanti a partecipare all'Assemblea e decidere se quest'ultima sia stata convocata regolarmente e se sussiste il quorum necessario per prendere decisioni. Il Presidente ha il diritto di presiedere le discussioni e di prendere decisioni sulle regole e sulle procedure in materia di voto.

10.16 Le deliberazioni, i verbali e l'elenco dei partecipanti all'Assemblea devono essere preparati immediatamente dopo l'Assemblea e saranno sottoscritti dal Presidente e dal Segretario dell'Assemblea, come anche dal notaio pubblico se richiesto dalla legge e saranno registrati nel libro delle deliberazioni della Società.

10.17 In deroga a quanto sopra, una deliberazione dell'Assemblea può essere presa efficacemente anche attraverso una delibera scritta circolante, purché questa delibera circolante sia sottoscritta da tutti i soci. La proposta di deliberazione, insieme a tutta la necessaria documentazione di supporto in allegato, deve essere inviata a tutti i soci, con ogni mezzo adeguato, che permetta di certificare l'avvenuta ricezione da parte di questi ultimi. La proposta deve contenere chiaramente i punti all'ordine del giorno e tutto quello che è necessario per una corretta informazione sull'argomento, nonché il testo finale della delibera da prendere. La sottoscrizione della delibera da parte di ciascuno dei soci determina l'orientamento di ciascuno di essi. Il quorum necessario per la deliberazione è quello previsto dall'articolo 11 dello Statuto. La data della deliberazione sarà considerata la data in cui la delibera è stata sottoscritta dall'ultimo socio. Le delibera e tutta la documentazione allegata che evidenzia la volontà espressa dal socio dovrà essere registrata nel libro delle deliberazioni della Società.

## Articolo 11 - Quorum e poteri dell'Assemblea generale

11.1 L'Assemblea dei soci delibera su tutte le materie previste esplicitamente dalla legislazione in vigore e dallo Statuto della Società.

11.2 L'Assemblea è regolarmente convocata e può prendere decisioni valide con il voto favorevole del 51% (cinquantuno per cento) del capitale sociale della Società, salvo disposizioni contrarie dello Statuto.

11.3 Fermo restando quanto sopra esposto, l'Assemblea è regolarmente convocata e può prendere decisioni valide con il voto favorevole dei soci che rappresentano almeno il 75% (settantacinque per cento) del capitale sociale della Società, relativamente alle seguenti materie:

i. modifiche dello Statuto della Società;
ii. aumento e riduzione del capitale della Società;
iii. ristrutturazione, liquidazione e scioglimento della Società o revoca delle delibere relative agli atti predetti;
iv. fusione, acquisizione o scissione della Società;
v. le delibere relative alla distribuzione o alla non distribuzione dei dividendi;
vi. costituzione di pegno o altra garanzia sulle quote sociali.

## Articolo 12 – Amministrazione

12.1 La Società è amministrata da un Amministratore unico.

12.2 L'Amministratore rimane in carica fino a dimissioni o revoca dall'Assemblea, per un periodo di 5 (cinque) anni fiscali dalla data di nomina, con possibilità di rinnovo. Se al termine del periodo di 5 (cinque) anni l'Assemblea non è convocata per la nomina del nuovo Amministratore, l'Amministratore rimane in carica con pieni poteri fino a che l'Assemblea deliberi per la nomina del nuovo Amministratore.

12.3 L'Amministratore rappresenta la Società nei confronti dei terzi, nei procedimenti giudiziari ed esercita tutti i poteri di ordinaria amministrazione della Società in conformità con quanto previsto dal presente Statuto, dalla legge n. 9901 del 14.04.2008 "*Per i commercianti e le società commerciali*" ("Legge Commerciale") e dalle delibere dell'Assemblea dei soci.

12.4 All'Amministratore vengono conferiti tutti i poteri necessari per svolgere tutte le formalità e gli adempimenti previsti per la costituzione e registrazione della Società secondo la legislazione e la normativa vigente. A tal fine, l'Amministratore potrà avvalersi dell'ausilio di terzi e di consulenti ai quali potrà delegare in tutto o in parte lo svolgimento delle suddette attività.

12.5 L'Amministratore può nominare procuratori speciali per l'esecuzione di determinati compiti o categorie di compiti, nei limiti dei poteri ad esso conferiti dal presente Statuto, dalla Legge Commerciale e dall'Assemblea dei soci.

12.6 L'amministratore non è retribuito per la sua carica, salvo che l'Assemblea dei soci decida diversamente. L'Amministratore ha diritto al rimborso delle spese effettuate e sostenute nell'esercizio delle sue funzioni.

12.7 L'Amministratore ha l'obbligo di informare i soci per quanto riguarda le sue attività, almeno ogni tre mesi oppure ad ogni richiesta dei soci titolari di quote.

## CAPITOLO IV
## ESPERTO CONTABILE REGISTRATO, ANNO FINANZIARIO, BILANCIO ANNUALE, DISTRIBUZIONE DEGLI UTILI

### Articolo 13 - Esperto contabile registrato

13.1 Qualora richiesto dalla legge o deliberato dall'Assemblea dei soci, il controllo dei bilanci d'esercizio e dei libri contabili della Società sarà affidato ad uno o più esperti contabili registrati.

13.2 L'esperto contabile registrato può essere revocato in ogni momento secondo le condizioni previste dalla legislazione in vigore.

### Articolo 14 - Anno finanziario e bilancio annuale

14.1 L'anno finanziario inizia il 1 gennaio e termina il 31 dicembre di ciascun anno.

14.2 I bilanci annuali e la relazione dell'Amministratore ed eventualmente dell'esperto contabile registrato vengono approvati dall'Assemblea con la maggioranza prevista nell'articolo 11.2 di cui sopra.

14.1 L'approvazione dei documenti relativi all'esercizio annuale avverrà entro 6 (sei) mesi dalla fine dell'anno finanziario.

### Articolo 15 – Utili

15.1 Previo l'adempimento dei criteri previsti dall'articolo 77 della Legge Commerciale, gli utili netti risultati dal bilancio annuale sono distribuiti – previa delibera dell'Assemblea con la maggioranza prevista dall'art. 11.3 di cui sopra – ai soci in proporzione al valore nominale della quota di capitale da ciascuno di essi posseduta, dopo avere detratto la quota a fondo di riserva che è stabilita a libera discrezione dell'Assemblea dei soci.

15.2 L'Assemblea dei soci è libera di destinare tutto o parte dell'utile a riserva oppure di posticipare la distribuzione dell'utile, in tutto o in parte, ai successivi anni finanziari.

## CAPITOLO V
## SCIOGLIMENTO E LIQUIDAZIONE DELLA SOCIETÀ

### Articolo 16 – Scioglimento

16.1 La Società si scioglie nei casi previsti dalla legge o per decisione dell'Assemblea dei soci, con la maggioranza prevista per la modificazione dello Statuto.

### Articolo 17 – Liquidazione

17.1 Nel caso di scioglimento la Società verrà posta in liquidazione.

17.2 Per gestire questa procedura l'Assemblea dei soci, con la maggioranza prevista dall'art. 11.3 di cui sopra, nomina uno o più liquidatori i quali redigeranno la relazione

finale sullo stato dell'attivo e del passivo della Società, sulle operazioni di liquidazione e sui tempi necessari per portare a termine la liquidazione.

17.3. Al termine della procedura di liquidazione l'Assemblea dei soci, con la maggioranza prevista dall'art. 11.3 di cui sopra, delibererà sul bilancio finanziario definitivo, sulla validità del lavoro svolto dal liquidatore e sulla fine dell'operazione di liquidazione.

17.4 Dopo il pagamento dei creditori e la riscossione dei crediti, il liquidatore/i distribuirà i proventi finali della liquidazione ai soci in proporzione al valore nominale della quota di capitale posseduta.

## CAPITOLO VI
## DISPOSIZIONI FINALI

### Articolo 18 - Composizione delle controversie

18.1. Tutte le controversie che dovessero sorgere tra i soci ovvero tra i soci e la Società e che riguardano l'interpretazione e l'esecuzione del presente Statuto saranno risolte esclusivamente dal Tribunale di Tirana.

### Articolo 19 – Disposizioni in vigore

19.1 Per tutte le materie non specificamente disciplinate dal presente Statuto, si applicano le disposizioni vigenti.

### Articolo 20 – Lingua

20.1 Il presente Statuto è redatto in lingua albanese con annessa la traduzione in lingua italiana.

20.2 Per tutte le controversie che dovessero insorgere relativamente all'interpretazione e/o esecuzione del presente Statuto, la versione italiana sarà l'unica legalmente vincolante.

I SOCI

**Per BPOINT INTERNATIONAL HOLDING S.R.L.**

_______________
Sig. Giuliano Zinni

GIULIANO ZINNI

**Sig. Dorart Sopoti**

DORART SOPOTI
_______________

INTERPRETE

Blerina Mbolla
_______________

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER ANILA K. GJERMENI**

V20210502961876520

**DATE 14/07/2021**
**NR REP 2076**

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 14.07.2021 , une Notere ANILA K. GJERMENI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.4, vertetoj se

**NËNSHKRUES/IT**:
GIULIANO ZINNI, atësia NICOLA, shtetas Italian, lindur në TERMOLI dhe banues në adresën Via Madonna Delle Grazie , 50 Termoli (CB), lindur më 15/12/1972, gjendja civile "I MARTUAR", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. personal CA74364DC.

**NËNSHKRUES/IT**:
Dorart Sopoti, atësia Fisnik, amësia Lejla, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Xh.Martini; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 29/06/1970, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031311459 dhe nr. personal H00629035B.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Aktin e Themelimit dhe Statutin (si shtojca 1) date 13.07.2021 i shoqerise "BP Tech SHPK" ne gjuhen shqip dhe ne gjuhen italiane , bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimet e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

ANILA K. GJERMENI